Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e pagueme

# RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО: ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE: TE ENJTEN DHE TE DIELEN

Redakcija Prishtina
Rruga Zmaj Jovina Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vjet 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorashkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Vjeti IV Nr. 140 | PRISHTINE, e dielle 29 Gusht 1948 | Çmimi 2 dinarë

*Blemja e drithnave te bardhe*

## Ma shum perpjekje per zhdukjen e te metave dhe per shpejtesimin e punes se blemjes

Nga rezultatet e deritashme shifet se blemja e drithnave te bardhe asht permiresue bukur shum ne disa rrethe te Krahines s'one si p. sh. ne Suhareke, Gilan, Gjilove, Peje, Vitine. Ne disa rrethe te tjera nuk mund te zbatohet ngritja e normes ditore, e cila tregon per çdo dite asht njisoj, kurse ne nji numer ma te vogel rretheve plotsimi i normes ditore ka ra, p. sh. ne rrethin e Podujeves, ku ma pare tejkalohej norma ditore, tash plotsohet vetem me 66,8%, mandej ne rrethin e Serbices, Istokut e te Prishtines.

Ne rrethet ku perpjekjet e keshillave te vendeve dhe t'organizatave te Partis e te Frontit popullor jane te vazhdueshme dhe ku jane perpunue planet mire, shifet se plotsimi i normes ditore po permiresohet dita-dites.

Mirepo, me gjithse se puna rreth blemjes se drithnave te bardhe asht permiresue mjaft ne shumicen e rretheve, prap se prap mbetet pa u-plotsue norma ditore ne mbare Krahinen per 37%, me gjithse tash blemja duhet te zhvillohet me hovin ma te madh. Kjo rrjedhe, ne rend te pare, nga se punohet e katundit e vazhdojne me zgjidhjen e dorezimin e tepricave te drithit dhe keto i dorezojne pjeserisht e ne sasina te vogla; mandej nuk e dorezojne drithin e paster, por te perziem mjaft me lende te hueja si p. sh. ne rrethin e Gilanit. Tue e analizue dorezimin e tepricave te drithit per kah ana e numrit t'ekonomive shtepijake, shifet se deri tash e kane dorezue drithin shumica e katundarve te vorfen dhe te vobekte. Per shembull ne Vuçitern plotsohet norma e sasinave te drithit te dorzuem me 68%, kurse norma e numrit t'ekonomive shtepijake plotsohet me 60%, kjo don me thane se drithin e dorzojne shumica e ekonomive te vorfna dhe te mesme, sepse sikur t'a dorzojshin drithin njisoj te gjitha ekonomit shtepijake, perqindja e drithit te dorzuem do t'ishte njisoj me perqindjen e numrit t'ekonomive shtepijake. Keshtu ngjan edhe ne rrethin e Gilanit e t'Istokut. Mandej asht konstatue se ne disa rrethe, si p. sh. ne rrethin e Serbices, Mitrovices, keshillat e vendeve nuk ua dergojne planet operative ditore stacjoneve te blemjes; kjo gja shkakton qe evidenca nuk mund te mbahet ne rregull, sepse nuk dihet se cila ekonomi shtepijake duhet te dorzojne drithin mbrenda dites e keshtu nuk mund te merren as masat perkatese.

Prandaj, tue qene se asht afrue mjaft koha e plotsimit te planit te pergjithshem te blemjes se drithnave asht e nevojshme qe keshillat popullore si te rretheve ashtu edhe te vendeve te perpiqen per zhdukjen e te metave te konstatueme dhe te bajne ç'mos qe norma ditore te plotsohet. Mandej aktivistat e organizatave te Partis dhe te Frontit te perpiqen edhe ma teper per t'u ndihmue organeve te pushtetit si per zhdukjen e te metave ashtu dhe per plotsimin e planit.

## Çashtjes se furnizimit te popullit punues duhet me i kushtue nji kujdes ma te madh

Me gjithse ne Krahinen t'one ekzistojne te gjitha kushtet e favorshme per furnizimin e mire te popullit punues, prap se prap sherbimi i furnizimit nuk asht ne nalltsin e duhun. Kjo rrjedhe nga shkaku se planet mujore dhe ditore nuk merren parasysh dhe nuk bahet nji punë e vazhdueshme per realizimin e tyne. Per shembull ne rrethin e Pejes, ku ekzistojne te gjitha mundesit e nevojshme jo vetem per furnizimin e mire te popullsis punuese te qytetit por edhe per eksportim ne rrethet tjera, popullsija vuen per mungese t'artikujve te ndryshem per shkak se plani nuk merret fare parasysh nga organet pergjegjese te furnizimit. Plani i muejit gusht nuk asht fa fare.

Mandej ne mbare Krahinen t'one nuk çfrytzohen ashtu si duhet burimet lokale. Kjo asht nji nder te metat ma te medhaja. Per shembull ne rrethin e Prizrenit ku ka mjafte peme dhe perime, populli punues vuen per nji kg. bostane ose domate. Ne rrethin e Ferizajt ku ka mjaft patate nuk asht ba kurrfar plani per çfrytzimin e burimeve te tyne, por keto po kerkohen nga rrethi i Prizrenit. Ne Prishtine asht mbajte nji konferencë me kopshtaret dhe asht ba nji marreveshje per blemjen e zarzavateve, mirepo, kjo marreveshje ka zgjate vetem nji dite, per arsye se organet e furnizimit e sidomos te sipermarrjeve tregtare shteterore dhe kooperative e kane lane mbas dore. Bile aq ma teper perfaqesuesi i kooperatives ne Prishtine e ka kundershtue caktimin e çmimeve t'artikujve bujqesore ne treg te lire ne baze te Dekretit perkates, tue thane se çmimi i specave, qe asht caktue 6 dinare, asht i vogel, duhet te jete 12 dinare etj.

Inspekcjoni i tregjeve nuk asht aspak aktiv. Pemet dhe perimet e bujqeseve lokale te Krahines s'one po shiten neper rrugica, shpija private dhe kopshtijet jane ba duqane te pemshitesave te dikurshem spekulanta, si per shembull ne Peje, Prishtine etj.

Çashtja e furnizimit te popullsis punuese mund te zgjidhet mjaft mire sikur t'angazhohen aq sa duhet drejtorinat e blemjes te keshillave popullore te rretheve, sipermarrjet e furnizimit, bashkimet e kooperativave dhe kooperativat e vendeve. Asht e nevojshme qe menjihere te parashifet plani i nevojave te vendit n'artikuj te ndryshem dhe te bahet lufte e vazhdueshme per realizimin e tij. Burimet lokale duhet te çfrytzohen ne maksimum, te zbatohet Dekreti mbi çmimet e prodhimeve bujqesore ne treg te lire, dhe Dekreti per blemjen e te gjitha prodhimeve nga bujqit e vobeget. Siç e ka theksue Ministri i Tregtis dhe furnizimit i RFPJ, Jakov Bllazheviq, kjo çashtje, sikurse edhe problemet tjera, nuk duhet te zgjidhet ne baze te formave kallype-shabllonike, por ashtu si na ka hije, ne menyre revolucjonare.

## Mbi sistemin e ri te pagimit te tatimit mbi t'ardhunat

Qeverija qendrore ka aprovue ne keto dite dekretin e ri per tatimet mbi t'ardhunat. Karakteristikat themelore te ketij dekreti jane keto:

Me pagimin e tatimit mbi t'ardhunat qytetaret t'one marrin mbi vedi nji pjese te ngritjes s'ekonomis s'one dhe te mbajtjes s'aparatit shteteror, i cili ma nuk rrnon si parazit ne kurrizin e shtresave te gjana te popullsis, por merr pjese aktive n'ekonomi dhe e udheheqe kete. Prandaj tatimi qe e paguejne popujt t'one shkon ne dobin e tyne, sepse me mjete e tyne ndertohen fabrika te reja, hekurudha, shkolla, spitale etj.

Çdo qytetar duhet me e dhane kontributin e vet simbas gjendjes ekonomike per mbajtjen e aparatit shteteror dhe per ngritjen e perparimin e gjithmbarshem te Vendit t'one.

Prandaj dekreti i ri parashef per t'ardhuna ma te shumta perqindjen ma te madhe dhe anasjelltas-sa ma pak t'ardhuna, aq ma pak tatime mbi to. Pra ky Dekret asht mjet i forte per kufizimin e pasunimit t'elementave kapitalista.

Veçanerisht duhet me e nenvizue momentin e ri ne Dekretin e sivjem, i cili parashef ngarkimin ma te madh me tatim per ata qe perdorin fuqin e huej puntore dhe qe pasunohen tue e çfrytezue kete.

Gjithashtu Dekreti i ri i tatimeve mbi t'ardhunat ban dallimin ne mes t'atyne bujqeve qe shesin me çmime te lidhuna dhe t'atyne qe shesin ne treg te lire. Ata qe shesin me çmime te lidhuna ngarkohen me ma pak tatim, sepse me nji ane i kane shite ma lire prodhimet e veta, e n'anen tjeter i kane ndihmue masat ekonomike te ndermarruna nga pushteti i jone popullor, kurse ata qe shesin ne treg te lire, kane realizue ma shum t'ardhuna tue spekulue dhe tue i ngrite çmimet, prandaj keta ngarkohen me ma shum tatim.

Keshillat popullore te rretheve duhet t'a çmojne drejte randesin e ketij Dekreti dhe t'i marrin masat e duhuna per kryemjen me kohe te te gjitha pregaditjeve per zbatimin e perpiket te tij. Duhet te formohen menjiheri komisjonet perkatese neper keshillat e vendeve dhe te rretheve, ne te cilat duhet te bajne pjese elementat ma aktive nga organizatat e Partis dhe organizatat popullore. Mandej duhet te llogariten drejte t'ardhunat e çdo ekonomije shtepijake e ne baze te ketyne te bahet caktimi i tatimit. Nuk duhet me lejue qe te veprohet si ne vjetin e kaluem ku ne disa rrethe caktimi i tatimit asht ba ma pare se llogaritja e t'ardhunave. Ne keto pregaditje duhet te marrin pjese aktive organizatat e Partis dhe organizatat popullore tue i ndihmue komisjoneve perkatese ndihmen e nevojshme e sidomos per sa i perket llogaritjes se t'ardhunave, sepse kjo pune asht parakusht per zbatimin e drejte te Dekretit.

## Gara ne ndere te Kongresit te Pare te Sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis

Keshilli sindikal i rrethit te Prishtines me daten 26 te k. m. ka mbajte mbledhjen plenare ne te cilen kane marre pjese kryetaret dhe sekretaret e te gjitha degeve sindikale te rrethit.

Ne mbarim mbledhja vendosi qe, ne nder te Kongresit te Pare te Sindikatave t'Unjisueme te Jugosllavis, t'iu shpalli garen keshillave sindikale te rretheve Mitrovice, Peje, Ferizaj dhe Gilan, rreth ketyne pikave:

Cili keshill do te mbrrije perfundime ma te mira ne perforcimin e organizatave te veta; cilat sipermarrje do te mbrrijne rezultate ma te mira ne plotsimin e planit te prodhimit; ku do te jete diciplina ma e mire; ku do te organizohet agjitacjoni ma mire; prane cilit keshille sindikal te rrethit do te pakesohet ma teper mbas Kongresit numri i analfabetve; cili keshill do t'organizoje ma mire punen per studimin e materjalit te Kongresit te V te PKJ dhe kush do te perfshije ma teper antare; cili keshill do te korre perfundime ma te mira n'organizimin e brigadave te punes dhe cila brigade do t'a kete evidencen ma te mire; ne rejonin e cilit keshill do te kete neper deget sindikale ma shum arka te ndihmes reciproke dhe ma shume antare ne to; prane cilit keshill do t'organizohet ma mire kontrolla shoqnore dhe ku do te mbrrihen rezultate ma te mira, cili keshill do t'i ape ma teper ndihme degve sindikale ne sipermarrjet me karakter krahinuer dhe lokal; cila shoqni kulturo-artistike do te mbrrije perfundime ma te mira ne rejonin e cilit keshill do te zgjidhet ma mire çashtja e deklarimit te udhetarve, dhanja e librezave dhe furnizimi i tyne; ku do t'organizohet ma mire rrjeta e korrespondenteve dhe kush do te dergoje ma shum korrespondenca per shtypin krahinuer dhe shtypin tjeter, dhe ma ne fund ne rejonin e cilit keshill do te jepin antaret e sindikatit ma shum ore pune vullnetare n'aksjonet punuese te Frontit popullor.

## Simbas planit te Keshillit ekzekutiv te Frontit popullor Krahinuer neper te gjitha rrethet do t'organizohet nga nji brigade puntore

Keto dite u-mbajte mbledhja e Keshillit ekzekutiv krahinuer te Frontit Popullor. Ne kete mbledhje u-zgjodh drejtorija e brigadave puntore te Frontit dhe asht perpilue orari i punes se brigadave puntore. Simbas planit te Keshillit ekzekutiv te Frontit popullor krahinuer, neper te gjitha rrethet do t'organizohet nga nji brigade frontiste puntore. Kto brigada do te punojne n'aksjone te ndryshme te punes ne Kosmet dhe ne Serbi. Çdo brigade do te kete, nga 200 deri ne 250 antar te frontit. Brigadat frontiste e punes nga rrethi i Pejes, Istokut, Drenices dhe te Prizrenit do t'i vehen ne disposicjon Sipermarrjes se pyjeve ne Peje per te punue ne pyjet e Rugoves. Brigada e rrethit te Ferizajt do te punoje ne punet pyjore te sipermarrjes se pyjeve ne Ferizaj. Brigadat e rretheve Suhareke, Rahovec, Dragash, Mitrovice e Vuçiternë do te marrin pjese ne ndertimin e hekurudhes se kolosekut normal Metohi-Prizren. Brigadat e rrethit te Llapit dhe Prishtines do te punojne ne hekurudhen e re Fushe-Kosove — Beljaqeve. Brigada e rrethit te Lipjanit do te punoje ne punime qe i zhvillon sipermarrja e ndertimeve ne Prishtine, e brigada e rrethit te Gjakoves do te punoje ne ndertimin e rrugeve pyjore te ketij rrethi. Brigadat nga rrethi i Gilanit dhe i Kamenices do te shkojne ne Serbi per te punue ne ndertimin e rruges pyjore Rudare—Prokuple (Prollom).

Udheheqesinat e organizatave te Frontit te rretheve duhet t'i marrin me njiher te gjitha masat e duhuna per t'i dergue brigadat e tyne sa ma pare ne vendet e caktueme si dhe per te sigurue udheheqesin e mire te brigadave, e cila te kujdeset per vendosjen dhe organizimin e punes se ketyne brigadave. Para se te nisen, brigadat duhet te jene te ndame ne çeta dhe ne grupe me udheheqesinat e tyne.

Organizatat e Frontit duhet te perpiqen qe ne brigada t'inkuadrohen sa ma shum femna. Percjellja e brigadave duhet te bahet ne menyre solemne dhe t'organizohet mire.

## Luftetaret e Armates s'one ndihmojne popullin e Drenices ne ndertimin e shtepijave kooperative

Para nji jave, komisari i garnizonit ushtarak te Serbices ne nji bisede qe pat me udheheqesit e Frontit popullor te rrethit, premtoi n'emen te luftetarve se jane te gatshem me kontribue fizikisht ne ndertimin e shtepijave kooperative. E me te vertete, nji dite, ata bashke me popull ndihmuen ne transportimin e 20.000 cope tullave prej nji largesije 2 kilometrash. Diten tjeter, vetem mbrenda disa oresh, ata bajten 50 metra kubik zalle.

Kjo asht nji nder provat e gjalla qe Armata e jone jo vetem qe e siguron dhe e mbron vendin t'one, por edhe njikohsisht i ndihmon popujt t'one ne ndertimin e socjalizmit.

Ne mbarim te punes, sekretari i Frontit popullor te rrethit i falenderoi luftetaret per ndihmen qe ata i dhane popullit te Serbices, dhe shprehi admirimin e popullit ndaj Armates s'one te lavdishme.

N'emen te luftetarve te saj njisisi foli Petriçeviq Krsto i cili shprehi vullnetin e vet e te shokve, tue premtue se do te jene te gatshem me ndihmue dhe ne t'ardhmen.

F. V.

**BORIS ZIHERL**

# Partija Komuniste e Jugosllavis - avangarde e njerzve punues te Jugosllavis

Qe Partija revolucjonare e proletarjatit te mundet me i realizue qellimet e veta çlirimtare, te cilat perputhen me interesat objektive te mbare popullit punues, para se gjithash jane te nevojshme dy gjana:

e para, vija e drejte politike ,d. m. th. çmimi i drejte marksist-lenjinist i kushteve objektive te luftes dhe mbrojtmi — ne baze te çmimit te drejte te kushteve objektive — i strategjis dhe taktikes se drejte;

e dyta, lidhja e pandashme me turmat punuese, transmetimi i vijes politike te Partis ne koshjence te ketyne masave, perbashkimi i tyne rreth Partis dhe vijes se saje, mobilizimi i tyne per shkak te luftes masovike revolucjonare per çlirimin nga eksploatimi dhe shtypja.

Rruga historike e Partis s'one, siç asht dhanue ne referatin e shokut Tito te mbajtun ne Kongresin e Peste, asht plotesisht rruga e luftes per realizimin e ketyne dy kushteve qe Lenjini dhe Stalini i kane spikate ma se nji here si kushte kryesore [illegible] dhe [illegible].

Lufta per vijen e drejte te Partis asht njikohesisht edhe lufte per unitetin e saje. Sikurse e verteta mundet me qene vetem nji dhe kriteri i saje asht praktika, po ashtu vetem nji vije politike mundet me u-pergjegje interesave objektive te turmave punuese te vendit te caktuem, te cilat nuk ndahen dhe s'mund te ndahen nga interesat objektive te njerzve punues te mbare botes dhe kriteri per drejtesin e vijes politike asht veprimtarija praktike dhe revolucjonare.

Ligji i zhvillimit te çdo Partije Komuniste, e cila formohet dhe rritet ne kushtet e ekzistimit te klasave te ndryshme me interesa dhe pikpamje te kunderta, asht lufta e papushueshme mbrenda Partis kunder influences ideologjike te klasave jo-proletare dhe t'eksponentave te saje. Ne referatin e tij ne plenumin e VII-te te zgjanue te Komitetit Ekzekutiv t'Internacjonales Komuniste, ne vitin 1926, shoku Stalin ka thane: „Proletarjati asht pjesa e shoqnis qe asht e lidhun me fije te shumta me shtresat e ndryshme te kesaj shoqnije." E Partija asht pjese e proletarjatit. Prandaj as Partija nuk mundet me qene e çlirueme kryekeput prej lidhjeve dhe influencave te shtresave te ndryshme te shoqnis borgjeze."

Klasat jo-proletare, influences ideologjike te te cilave u ekspozohet jo vetem klasa puntore, por edhe avangarda e saje, Partija komuniste, jane ase klasa haptazi armike (pronaret e mdhaj e borgjezija,tue e perfshi edhe borgjezin e katundit) ase klasa, aspiratat subjektive te te cilave, te çfaquna n'ideologjin e tyne, ndahen jo vetem nga vija e perparimit te pergjithshem njerzuer, por edhe nga interesat e veta objektive, qe mundet me u-realizue vetem me rrezimin e kapitalizmit dhe me vendosjen e pushtetit te popullit punues, vetem nen udheheqjen e [illegible] (mikroborgjezija e qytetit dhe e katundit).

Influenca ideologjike e shtresave jo proletare çfaqet ne perpjekjen e perfaqesuesave te saje ne Parti me i fute ne te vijes e shtremet politike,vijen qe [illegible] interesat dhe aspiratat e [illegible], si shtresa ma perparimtare e shoqnis njikohesisht, vijes, dhe [illegible] demobilizimi rradhet revolucjonare dhe lehtesojn realizimin e planeve kundra-revolucjonare te borgjezis. Influenca ideologjike e klasave jo-proletare çfaqet ne perpjekjen e perfaqesuesave te saje ne Parti qe rreth vijes se vet te mbledhin sa ma shume [illegible] Partije dhe te krijojne grupin e vet politik mbrenda vet Partis, te krijojne frakcjonin e vet, t'a thejne unitetin e Partis dhe t'a paralizojne fuqin e saje mbrenda. Lufta per vijen e drejte politike te Partis asht, pra, njikohesisht edhe lufte kundra frakcjoneve ne Parti, per unitetin e saje, per spastrimin e Partis nga elementat e huej, per perjashtimin e frakcjonave te hueja armike ne Parti.

Partija e jone asht rrite dhe perforcue plotesisht neper mjet te kesaj lufte.

Nga referatet, qe jane mbajte ne Kongresin e Peste, e sidomos nga referati i shokut Tito, rrjedhe kjartazi se periudha fenniore e Partis s'one dhe dhetvjetori i pare i zhvillimit te saje jane te mbushuna me luften e rande mbrenda Partis ne mes te frakcjonit te djathte dhe "te majte" me perpjekjen e vendosun t'elementave te perkushtuem Partis qe fuqit e saje te mblidhen ne plateformen revolucjonare bolshevike te luftes ne dy fronte, kunder oportunistave te djathte dhe "te majte", per vijen unike politike revolucjonare.

Reakcjoni i djathte i cili ka mbizotnue ne Parti ne vjetet e para te zhvillimit te saje ka mishnue ne vetvehte trashigimin social-demokratik te vitit 1919, kur Partija u-themelue me bashkimin e Partive dhe grupeve, te cilat ma perpara jane zhvillue nen influencen e forte te social-demokracis perendimore dhe posaçerisht nen [illegible] jal-demokracis austrijake t'austro-marksistave. Sikurse dihet, oportunistat nga social-demokracija tue veprue si percjellse t'influences ideologjike borgjeze dhe mikro-borgjeze n' levizjen puntore, e kane braktise kien e Marksit mbi revolucjonin dhe diktaturen e proletarjatit. Oportunistat e djathte ne PKJ i kane pergatue formalisht keto dy ideja te Marksit por i kane mbajte te gjitha ato qe kane dale direkt nga braktisja reformiste e ketyne ideve: indiferentizmin e bile qendrimin negativ ndaj çashtjeve aq me randesi sikurse ja ne çashtja kombetare dhe katundare, d. m. th. ndaj çashtjeve t'elementave te proletarjatit ne revolucjon. Shoku Stalin ne "Bazat e lenjinizmit" e ka zbulue deri ne fund esencen e ketij qendrimi ndaj çashtjes katundare dhe kombetar i cili ka qene dhe ka mbete tipik per partit e Internacjonales se dyte: „Kush i frigohet revolucjonit, kush nuk don me i çue proletaret kah pushteti, ai nuk mundet me u-interesue per çashtjet mbi aktuale e proletarjatit ne revolucjon, — per te cilin ja e aleateve asht çashtje indiferente, jo-aktuale".

Per shkak te mos-perfilljes se çashtjes katundare dhe kombetare nga ana e oportunistave te djathte ne Parti, Proletarjati i Jugosllavis nuk ka qene ne gjendje me e luejte dhe mbajte rolin udheheqes ne levizjet e katundaris dhe te masave te shtypuna kombtarisht, te cilat u-ndezen me fuqi qysh ne vjetet e para t'egzistences se Jugosllavis se vjeter. Ne vend te hegemonis te proletarjatit ne levizjen popullore kunder eksploatimit dhe shtypjes kombetare ka ardhe konsolidimi i partive opozitare e, n'esence, pa ja te kompromisit dhe trathtis te borgjezis nacjonale dhe t'udheheqsave te saje, e lloj lloj miqve te rrejshem te katundaris dhe nacjonaleve te rrejshem te se drejtave nacjonale. Roli objektiv i klases i oportunizmes se djathte ne PKJ sot asht plotesisht i kjarte.

Si denim per gabimet e oportunistave te djathte ka dale ne shesh epidemija e aventurizmit s'ultra-majte, eksponenti i se cles ka qene frakcjoni "i majte" ne Parti i cili, ne kohen ma te veshtire dhe ma kritike per Partin, mbas vendosjes se diktatures monarko-fashiste te 6 kallnorit, ne vjetin 1929, u-ba faktor vendimtar n'udheheqesin e Partis. Ne politiken e frakcjonit "te majte" gjetne shprehjen e vet frymezimet e dishpruene, te cilat, me rastin e vendosjes se diktatures se 6 kallnorit, perfshin disa shtresa t'inteligjences se Partis dhe elementa te tjere mikroborgjez ne Parti. Parolla e "kryengritjes s'armatosun", te cilen ne vjetin 1929 dhe ne vjetet e pastajme e lodhi udheheqsija jo-ma-majte e Partis, si edhe thirrja drejtue puntorve per me dale nga sindikatat legale "reformiste", si edhe aderencarjet e tjera eventuriste te kesaj udheheqesije e kane çue Partin drejt izolimit prej masave, qe praktikisht domethone ka pa si rezultat, qe linda politike e frakcjonit te djathte ne dhetvjetorin e pare te zhvillimit te PKJ.

Lenjini dhe Stalini gjithmone kane theksue se shmangeja ne te "majte" ne Parti, ne realitet nuk asht kurgja tjeter perveç se ana e kundert e medaljes, ana e dyte e shmangejes ne te djathte. Ne shkrimin e vet "semundja foshnjore" e shmangejes ne te majte ("ne komunizem" ne kaptinen e katert Lenjini ka dhane analizen e shkelqyshme te substances se klases te shmangejes ne te "majte" ne Parti. Tue e permbledhe, ne realitet, kete analize te Lenjinit shoku Stalin qysh ne referatin e permendun te vjetit 1926 ka thane: "Ne qofte se ultra-majti" perpiqet per revolucjon vetem per arsye se mendon se revolucjoni do te filloje qysh neser, atehere asht e kjarte se mundet me ra ne deshprim dhe me e humbe entuziazmin per revolucjonin ne qofte se ai mbetet, ne qofte se revolucjoni nuk fiton qysh diten e neserme".

Keto tipe te Stalinit gjithashtu i perkasin plotesisht edhe politikes se frakcjonit te „majte" ne Partin t'one, e cila i ka çue keta faktor te vete ne gerzimin e pa-parimsis, te trockizmit, veprimtaris shkatrrimtare koshjente ndaj Partis. Kjo asht edhe kryekeput e natyrshme: zbatimi i politikes se gabueshme, ne substance, borgjeze, apo mikroborgjeze ne Parti, shoqnohet domosdoshmenisht me lulezimin e vijave karakteristike ma negative t'atyne shtresave shoqnore joproletare, influenca ideologjike e te cilave ne proletarjatin e Partin ushtrohet neper mjet te frakcjonistave te djathte dhe „te majte". Prej ketyne vijave karakteristike duhet me spikate, para se gjithash, lokalshmenin dhe pa-parimsin, ambicjozitetin dhe karjerizmin e semunde, korrupcjonizmin, shpirt-vogelsin dhe frymen e grupeve. Me kete rast t'a themi edhe kete: faktet provojne se plotesisht keto veti na çfaqen si fuqi levzese ne shumicen ma te madhe te rasteve te mohimit te Partis s'one, per aq sa ky ngjet ne kohen e tanishme te veshtirsinave ser joze per Partin dhe per mbare popullin puntor te Vendit t'one. Ne mes te mohuesave ndeshim si rregull, eksponentat e perbetuem te frakcjonizmit te vjeter ne Partin t'one, trockistat, petkistat, likuidatoret e parti-luftes, grupistat, literatet dekadent, te perjashtuem ma se nji here, etj. Kjo rrethane i ka ba shum njerez te na dhe duhet t'i baate edhe perjashta, me e vue gishtin ne tamthe e me mendue odte.

* * *

Lufta e elementave te perkushtuem revolucjonit dhe Partis, lufte e cila, gjate dy dhetvjetave nuk pushon per asnji ças dhe asht e shoqnueme me emnat e Gjuro Gjakoviqit e te nji serije udheheqsish te tashem te Partis, me shokun Tito ne krye ,ne vjetet 1936-38 asht kurorzue me shpartallimin e frakcjonit te djathte dhe „te majte", me demaskimin dhe perzanjen e tyne nga udheheqsija.

Keto ndryshime te randesishme ne jeten e Partis s'one kane ngja ne kohen kur mbi popujt e Jugosllavis kercenohej rreziku i skllavnimit te tyne nga ana e agresorve gjermano-italjane. Ne kete situate, ma teper se kurr nji here tjeter ,duhet pa tjeter te çfaqej permbajtja revolucjonare e eksperimentimit me lloj lloj kombinatash te perzgina politike dhe me taktika politiko-organizative artificjale, qe ishin ne krenat e frakcjonistave, lagje rezultati shoqnor jugosllav, n'emigrim, pa analizue te drendoshe mark sije lenjiniste te gjendjes reale ne Vend e pjeserisht deri edhe me qellimin koshjent per shkaterrimin e organizatave te Partis ne Vend, per izolimin e tyne nga masat. Ne kete situate, asht forte se kurre nevojshet nji udheheqsi Partije qe — ne menyre direkte, tue u-ndodhe me ne Vend, e armatosun me teorin e marksizem-lenjinizmit ,tue perdore eksperjencen e pasun te PK (b) te BRSS se si duhet t'i udheheqe Partija masave e gjana te popullit puntor, si edhe direktivat e çmueshme te shokut Stalin ne lidhje me çashtjen e politikes nacjonale te PKJ, — t'i zgjidhte çashtjet urgjente te levizjes revolucjonare te Vendit, nga zgjidhja e drejte e te cilave atehere mvarej fati i popujve te Jugosllavis.

Veprimtarija e udheheqesis se re te Partis, qe mure timonin e Partis ne duart e veta, ne vjetin 1937, shenjon nji kthese te madhe ne politiken e Partis s'one, kthese ne drejtim te zbatimit krijues te marksizem-lenjinizmit ne çashtjet konkrete te realitetit jugosllav, ne drejtim te luftes konsekuente per realizimin e hegemonis se proletarjatit ne levizjen demokratike te masave te çfrytzueme dhe kombetarisht te shtypuna te Jugosllavis, per izolimin nga masat te te gjithe miqve te rrejshem te popullit per lidhshmenin gjithnji ma te forte te Partis me masat popullore, ne radhe te pare me klasen puntore.

Engelsi shpesh here dishronte me perdore fjalen e urte popullore angleze "ne daç me dijte se qysh asht pudingu duhet me e hanger", tue e theksue me ket randesin e veprimtaris praktike si kriterjum ma i shendoshe i drejtesis se nji teorije apo linje politike, te ndertueme ne baze t'asaj teorije.

Rolin qe ka luejt Partija Komuniste e Jugosllavis ne prag dhe gjate luftes Çlirimtare te popujve te Jugosllavis kundra pushtuesave te huej fashista dhe trathtarve te mbrendeshem nga rradhet e reakcjonit borgjez si dhe rezultatet politike dhe ekonomiko-shoqnore te kesaj lufte ne Jugosllavi, jane padyshim kriterjumi ma i shendoshe qe provon drejtesin e politikes s'udheheqsis se re te Partis prej vjetit 1937 e kendej.

N'artikullin e tij "lufta Nacjonal Çlirimtare dhe çashtja organizative e Partis s'one", shoku Tito, me 1942, ka mujte me plot te drejte me shkrue: „PKJ nuk i erdhen pa prite e pa kujtue ngjarjet qe u-zhvilluen ma vone. Ajo nuk u-zue ne befe, por ishte pregadite ne çdo pikepamje t'i pritte ngjarjet me nji fiuçe te caktueme ç'ma pare dhe me vendime te marruna me kohe se çka duhet me ba. Organizativisht e perforcueme dhe unike, me nji kuader palodhshme nisht te perkushtuem, PKJ i priti me gatim ngjarrjet e veshtira dhe vendimtare".

Mbrenda nji kohe perqjesisht te shkurte, udheheqsija e re e Partis mundi me nxjerre Partin nga gjendja e i sektarizmit dhe frakcjonizmit, nga izolimi prej masave, me e ba udheheqse te vertete te masave per here ma te gjana popullore. Ajo ia doli kesaj pune ashpe kunder vegrol me kohe dhe si duhet ne luftje me te gjitha problemet urgjente te jetes se perditshme politike, ekonomike e kulturale te Jugosllavis, sipas e disa gjykimin e drejte mbi pozitat e mbrendeshme e te jashtme te Jugosllavis dhe atuer pa kete gjykimi perfundime te drejta tue shtrue para antarve te Partis detyret e dahuna perkatese: Me lufte per unitetin e klases puntore, e cila asht e destinueme me e luejte rolin vendimtar ne betejat e mdhaja qe vijne, me lufte per shtrengimin e rradhve te masave punuese te qytetit dhe te katundit, si dhe te te gjithe elementave te ndershem patriot prej shtresave tjera shoqnore, me Frontin popullor antifashist, per permbysjen e sundimtarve antipopullor, nga rradhet e oligarkis se madhe financjare, rrashve te Hitlerit dhe trathtarve te vendit te vet, me lufte per vlerësimin e te drejtat e barabarta te popujve te Jugosllavis, me lufte per bashkepunimin ma te ngushte me Bashkimin Sovjetik, si linje kryesore e politikes se jashtme te Jugosllavis.

Ne saje te linjes se drejte politike dhe zbatimit te saje konsequent ne te gjitha etapat prej zhvillimit te mbrendeshem dhe nderkombetar para vjetit 1941, PKJ mujti qe, qysh para luftes, t'i vente themelin ma te shendoshe levizjes s'ardhshme Nacjonal—Çlirimtare, te realizoje unitetin e klases puntore te Jugosllavis.

Me rrejon nga pushte nga masat puntore, ne ndermarrje, tue i perfitue njikohesisht elementat e ndershem perparimtar nga udheheqsit e sindikatave socjaldemokrate ,socjalkristjane e tjera, shtrengohen rradhet e klases puntore. Pjesen ma te madhe te sindikatave te klases, te puntorve dhe nepunsave, e udheheqe Partija Komuniste e Jugosllavis. Si pergjigje ndaj shpresaljeve te regjimeve kapitulante Stojadinoviq—Cvetkoviq—Maçek, ndaj shperndarjes se sindikatave te klases, lindin komitetet e bashkimit puntor — shtylle kuadre e organizatave te Frontit popullor.

Tue krijue Frontin antifashist popullor ne Jugosllavi Partija e jone ka qene koshjente se do te perfaqesoje fuqi serjoze politike vetem atehere kur te ndertohet ne nji platforme te bashkimit politik, ne qofte se do t'udhehiqet ne baze te nji plani te bashkuem strategjik, te perpiluem ne baze te çmimit te drejte te pozites se mbrendeshme e te jashtme. Nji keso platforme, nji plan t'atille dhe ate çmim mujti me e propozue PKJ.

Tue luftue per bashkimin e klases puntore dhe grumbullimin rreth saje te shtresave ma te gjana popullore, PKJ ne pragun e luftes çlirimtare i mposhti te gjitha tentativat e rimekambjes se frakcjonive te shkatrruesve ne Parti, zhvilloi lufte ne te gjitha zonat ne te cilat armiku i klases me anen e kanalave te ndryshme u perpoq me influencue ideologjikisht n'antaret e Partis ajo luftoi kundra tentativave te mbrendeshme te revizjonizmit ne filozofi, kundra dekandences shartuese n'art etj.

Materjalet e konferences se peste n'adhe, ne vjetin 1940, jane dokumenta te nji lufte te qendrueshme dhe te sukseshme per linjen e drejte te Partis ne pragun e ditevet ma vendimtare te historis s'one nacjonale, per hegjemonin e proletarjatit ne levizjen popullore antifashiste.

**Specificiteti i Frontit Popullor ne Jugosllavi qendron me te vertete ne faktin se Partija Komuniste e Jugosllavis, qysh ne fillim faktikisht nuk e ka nda me askend rrolin udheheqes ne levizjen e pergjithshme popullore por e forcoi, pa pra dhe pa u lodhe, rrolin e vet udheheqes per me ua mberrijte qellimeve te cilat u pergjigjen interesave objektive te te gjithe njerzve punuesa te Jugosllavis, klases puntore, katundaris punuese dhe inteligjences popullore.**

Tue zbatue vendosmenisht politiken e drejte, te mbeshtetun ne linjen definitive te popullit punues te Jugosllavis, PKJ mbas shkatrrimit te Jugosllavis se vjeter dhe falimentimit te te gjitha partive te vjetra, borgjeze e mikroborgjeze, te regjimit e „t'opozites", mujti me u ba fuqija udheheqse dhe drejtuese ne jeten politike te Jugosllavis. Ajo i vuni ne levizje turmat popullore te Jugosllavis ne luften çlirimtare, tue forcue ne to bindjen se do te çlirohen me te vertete vetem tue luftu aktivisht, me arme ne dore, krah per krah me Bashkimin Sovjetik dhe me te gjitha fuqite demokratike, antifashiste te botes. „Mos me prite qe lirija te vije vet, por me aksjonin t'one duhet me e ndihmue luften madheshtore t'Armates se Kuqe dhe te te gjitha fuqive antifashiste ne Jugosllavi dhe ne mbare boten...; me prite qe lirija te na vije vetem nga gjaku i popujve sovjetik dhe se do t'a marrim si dhurate ne pjaten e arte, asht njisoj si me dezertue nga fronti çlirimtar", ka shkrue shoku Kardel ne maj te gushtit te vjetit 1941.

Fronti Popullor u forcue neper luften kundra armiqve te hapet e te mshefet te mbrendeshem e te jashtem, te liris dhe pamvarsis se popujve te Jugosllavis, tue perqendrue ne bazen e vet organizimin politik gjithnji ma masovik te puntorve, katundareve punues e t'intelektualve popullore. Ai u ba burimi i pa shterrshem i kuadrave te reja per Partin Komuniste te Jugosllavis, forma specifike e aktivitetit dhe organizimit te popullit punues te Jugosllavis si mbeshtetje masovike e politikes se PKJ.

* * *

(Vazhdon ne faqen e trete)

# Partija Komuniste e Jugosllavis - avangarde e njerzve punues të Jugosllavis

Ne saje te lidhjes vendimtare qe ka ardhe, ne vjetin 1937, ne qashtjen e punes se Partis ne turmat, ne saje t'orjentimit te Partis ne punen e kajdreshme te vendosun, t'cen anike dhena e kane lejue kuadrot e Partis para vjetit 1941, te hapet me turmat, ne saje te luftes se vazhdueshme dhe te pa-pajtueshme kunder oportunistave te djathte dhe likuidatoreve, si edhe kunder llej lloj etzovistash dhe sektashesh te Jugosllavis, luftes se cilen e ka ba Partija si me rastin e Votimeve te vjetit 1938, ashtu edhe ne lidhje me qashtjen e themelimit t'organizatave politike legale te klases puntore dhe te turmave populIore ton fryme antifashiste, akkurt, ne saje te vijes se vet te drejte politike, strategjis dhe taktikes se vet, PKJ ka muejte me i mbledhe rreth vehtes turmat ma te gjana te populli punues te Jugosllavis dhe te bahet faktori i mbrendeshem politik ma vendimtar i fitores se popujve te Jugosllavis ne luften Çlirimtare.

Natyrisht, do t'ishte marri me pohue se jugosllavet jane çlirue vet; qe turmat punuese te Jugosllavis nen udheheqjen e PKJ kane fitue pa ndihmen e askujt, pa marre parasyshe raportin e fuqive ne perpjestimet nderkombtare. Çka do qe te thase ky ose ay, nji gja asht e sakte: ky pohim i tillje nuk asht rritë n'arena e Jugosllavis, as dhe ay te gjoja udheheqsit e Partis te Jugosllavis pretendojne me e ndertue vetem socjalizmin ne Jugosllavi, kurse eganton BRSS dhe vendet e demokracis populIore. Asht fakt historik se udheheqesija e PKJ ne gjykimet e veta mbi gjendjen dhe perspektivat e zhvillimit gjithmone asht bazue ne rolin historiko-botnor te Bashkimit Sovjetik, ne misjonin çlirimtar te vendit te pare te socjalizmit. N'artikullin e vet me rastin e 25 vjetorit te Revolucjonit te Madh Socjalist te Tetorit, shoku Tito ka shkrue: „Njizet e pese vjete popujt e Bashkimit Sovjetik e kane ndertue vendin e vet, ne menyre qe sot te gjitha frytet e vata e edhe gjakun dhe jeten e vet t'a vejne ne sherbim te mbare njerzimit perparimtar. Çka do t'u kishte ngja sot popujve te robnuem dhe te mbare njerzis perparimtare, sikur te mos ishte Bashkimi Sovjetik dhe Armata e tij e Kuqe e pathyeshme, e cila e mban ne kurrizin e vet gati te tane barren e luftes kunder zaptuesve fashista.

Por do t'ishte gja anti-shkencore, per mos me thane ma teper, me e mohue faktin historik qe popujt e Jugosllavis nen udheheqjen e PKJ ne luften Çlirimtare te vjeteve 1941 — 1945 kane dhane çdo gja, çka ka muejte me dhane cdo vendi i tyne relativisht i vogel ne kushtet historike konkrete per çlirimin e vet, qe ky kontribut i tyne relativisht shum i madh per çashtjen e perbashket te popujve liridashes, para se gjithash, ka qene i mundun ne saje te lidhjes se ngushte te PKJ me turmat e gjana populIore, me klasen puntore, me katundaret dhe me inteligjencen populIore. Tue mbeshtete ne perkrahjen dhe ne besimin e kesaj te turmave, PKJ nepermjet te luftes me okupatoret e jashtem dhe me reakcjonin trathtar te Vendit e ka zgjanue vazhdimisht deren e kryengritjes populIore tue e transformue ne lufte te vertete Çlirimtare, ne te cilen per kunder trupave te zaptuesit te jashtem dhe te llandsknechtve te tyne te vendit kane qendrue brigada, divizjone dhe korpuse t'ushtris Nacjonal-çlirimtare ne Jugosllavi.

Progesi i transformimit te kryengritjes populIore ne luften populIore per çlirim, ne realitet perishin perfudhen e viti 1941 dhe 1942, pra perpadhe kur, sikurse e ka theksue shoku Stalin ne pershendetjen e vet drejtue popullit rus, me 24 Maj te vjetit 1945 ne frontin lindjer ka qene situate shum e veshtire, kur Armata Sovjetike terhiqej, sepse nuk kishte rrugedalje tjeter. Kjo ka qene perfudhe e ergjive te dejuna t'okupatorit, te triumfimit dhe te dukunes gjithnji ma te madhe t'elementave kuislinge ne vendet e robnuame te Jugosllavis, perfudhe e gadi cinik te reakcjonarve Anglo-Amerikan dhe e te gjithe atyne, te cilet kane lucite, ne Jugosllavi, me dy leta, me ate t'okupatorit dhe t'Anglo-Amerikanve.

PKJ me anen e kuadrove udheheqese puntore n'Ushtrin Nacjonal-çlirimtare dhe n'arradhat partizane, me anen e aktivistave te Partis ne teritoret e pushtueme te Jugosllavis, ka mbjelle ne turmat e gjana populIore besimin e paperkulun ne pathyeshmenin e Armates se Kuqe dhe ne deshtimin e pashmangshem te Gjermanis hitlerjane. „Stalingradi qendron, Stalingradi do te qendroje; ne Stalingrad, si edhe ne Kaukaz, hordhit e Hitlerit do te hane grushtin e dyte vdekdor, edhe ma te rande se ate te vjetit te kaluem nen bedemet e Moskes. Ky asht fakti qe na ep edhe ma teper besim se na, bashke me popujt e Bashkimit te Madh Sovjetik, patjeter do te fitojme". Ne keto fjale te shokut Tito, te thanuna me 17 Tetuer te vjetit 1942, me rastin e dorezimit te flamurit brigades se dyte proletare, shprehet fryma te cilen PKJ e ka perforcue sistematikisht dhe me vendosmeni ne turmat e gjana populIore, ne mes te luftarve t'Ushtris Nacjonal-çlirimtare dhe arradhave partizane te Jugosllavis ne kohen kur lufta çlirimtare ne Jugosllavi asht ba ne kushtet e blokades se plote italjano - gjermano-hungareze - rumune - bullgare. Te frymezuem me kete besim te pa-perkulun, luftetaret e Jugosllavis gjate vjetit 1943 dhe 1944 kane çlirue krahina mbas krahinash t'atdheut te vet, vise e hapsina te Bosnes, Dallmacis, Sllovenis, Malit te Zi, dhe, tue e çlirue Serbin, e kane jetue takimin historik me Armaten e Kuqe ne Danub, takim i cili ka shenjue fillimin e luftave te fundit per çlirimin e plote te Jugosllavis prej okupatorve gjermano - fashista.

PKJ u ka qendrue te gjitha peripetive te randa te luftes çlirimtare, sepse asht mbeshtete ne perkrahjen dhe besimin e turmave ma te gjana te popullit. Vetem ne saje te lidhjes se ngushte me turmat, udheheqesija e PKJ ka mundet me mberrijte suksese, me te cilat jane krijue te gjitha kushtet e mbrendeshme politike kryesore te zhvillimit te matutjeshem te Vendit drejt socjalizmit.

Me te vertete, nuk mundet me qene ndryshej veçse qesharak ai qe ne kundershtim me te gjitha faktet e mirenjoftuna, i cilet dhe shkruen ne kryeartikullin e numerit te fundit t'organit te Byros Informative keto fjale: Udheheqesit e PKJ-s perpiqen me u paraqite se gjoja jane te lidhun me turmat. Por, sa e kuj dhe e larget qe asht polera anti-Sovjetike, anti - marksiste, nacjonaliste e renegaive Jugosllave te socjalizmit prej lidhjes se vertete organike marksiste-leniniste te Partive komuniste dhe puntore me popullin, lidhje, e cila nuk realizohet me anen e fushates plote nervozizem administrativo-policore, por prej vjetit ne vjet, prej dites ne dite, me kujdes, me vendosmeni, me anen e punes sistematike dhe te hapet me turmat!"

Kambengulja, ne te cilen perpiqen qe bash akuzave ma perbindeshe kunder udheheqesave te Partis se Jugosllavis t'u apin fuqin e paragjykimit, me te vertete meriton qe te perdoret diku ma mire.

* * *

Partija Komuniste e Jugosllavis asht avangarda, pjesa ma koshjente e klases puntore te Jugosllavis dhe e njerzve punues te Jugosllavis pergjithesisht. Ajo asht e tille, sepse vija e saje politike asht e ndertueme ne bazë te theoris se Marksit - Engelsit - Leninit - Stalinit dhe veprimtarija e saje praktike u-pergjigjet interesavet objektive te klases puntore dhe aspiratave te kahershme te te gjithe proletarve me koshjence klase, sepse ajo asht e vetmja Parti ne Jugosllavi, e cila turmave te gjana te katundaris punuese dhe shtresave te tjera te mesme punuese u ka tregue dhe u tregon rrugen e shpetimit nga mjerimi dhe skamja, nga rrenimi dhe shkatrrimi masovik, me te cilen i deron kapitalizmi.

Transformimet revolucjonare, te cilat kane ardhe ne Jugosllavi gjate luftes Çlirimtare dhe si rezultat i kesaj, shenojne krijimin e parakushteve politike dhe ekonomiko-shoqnore themelore per mberritjen e qellimit shoqnuer te klases puntore, si klasa ma perparimtarja e shoqnis njikohtare.

Permbysja nga pushteti e kapitalistave dhe e pronarve te mdhaj, te cilet, ne shumicen e vet absolute nga shtytjet e ngushta te klases, e kane trathtue popullin ne dite e tij ma te veshtira dhe jane bashkue me shtypsat e jashtem, shenon realizimin e parakushtit politik themelor per ndertimin e socjalizmit ne Jugosllavi, ngadhnjimin historik te klases puntore te Jugosllavis mbi borgjezin e vet.

Nacjonalizimi, domethane kalimi ne pronesim te popullit, i te gjitha ndermarrjeve kapitaliste ekonomike n'industri, tregti, komunikacjon etj., shenon realizimin e parakushtit themelor shoqnoro-ekonomik per ndertimin e socjalizmit ne Jugosllavi, kalimin e pozitave kyçe t'ekonomis populIore ne duert e popullit punues.

Perbashkimi-me ekzistimin e dy parakushteve te para te ndertimit socjalist ne Jugosllavi-i turmave te gjana te katundaris punuese ne kooperativat bujqesore, te cilat duhet te bahen mjet i forte i luftes se katundarve te varfen dhe te mesem kunder elementave eksploatues ne katund, kunder pasanikeve te katundit, fajdexhive dhe spekulluesve, mandej, masat e pushtetit populIuer, te cilat, n'etapen e sotshme synojne kufizimin dhe shtypjen e elementave eksploatues ne katund, - e gjithe kjo i sjelle kontribut mbylljes s'atyne kanaleve nepermjet te cilve u rrjedhin nektaret jetesor mikrobeve te ndryshem te kapitalizmit ne katund, e gjithe kjo çon kah likuidimi i shtresave te fundit eksploatuese ne Vendin t'one, kah çlirimi i njerzve punues te Jugosllavis nga çdo eksploatim dhe shtypje.

Tue zbatue besnikisht liojen e forcimit e te gjitha ketyne nijoezave te mbrendeshme te ndertimit socjalist ne Jugosllavi, tue u-perpjeke me kete rast per forcimin e njikohshem e te gjitha hipotezave te tij te jashtme, per bashkpunimin gjithnji ma te ngushte ekonomik, politik e kultural me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e demokracis populIore, PKJ do t'a forcoje edhe ma teper lidhshmenin me turmat punuese.

Kongresi i Peste i PKJ ka prue nji seri konkluzash, te cilat i perkasin forcimit te matejshem te lidhjeve te Partis me turmat dhe zhdukjes se te gjitha te metave qe kane egzistue dhe egzistojne ne ket pikpamje ne veprimtarin praktike t'organizatave te Partis.

Ne zbatimin e politikes se vet, Partija e jone gjithmone asht mbeshtet, ne rend te pare, ne klasen puntore te Jugosllavis, si para luftes ashtu edhe ne kohen e luftes dhe mbas luftes. Ne kohen e luftes puntoret e Jugosllavis i formuen njisit e para partizane dhe dhane nji seri udheheqesash te shquem politike dhe ushtarak; ata kane mbjelle ne turmat joproletare te levizjes Nacjonal-çlirimtare frymen e organizimit, disiplines, solidarsis, te qendrueshmenis deri ne fund. Ne procesin e ndertimit te Jugosllavis se re, klasa puntore asht shtylla kryesore shoqnore e pushtetit populIuer, ajo ne procesin e industrijalizimit dhe elektrifikimit te Vendit rritet vazhdimisht dhe i zene pozitat ma te dalueshme ne punen per ndertimin e socjalizmit ne Vendin t'one. Prandaj asht krejtesisht e kuptueshme fjesa e shokut Rankoviq, i cili ne referatin e tij ne Kongresin e Peste e tregoi nevojen e kurdi ma te guximshem persa i perket pranimit te puntorve ne Parti, ne rend te pare te puntorve industrijal. Ne vend t'elementave te pavendosun dhe te lluej, te cilet kane te gatshem me i çue duert para çdo veshtiresije te ndertimit socjalist dhe te shkepunun nga Partija, duhet te hyejne me dhetra dhe qinda puntore nga ndermarrjet, nga fabrikat, transporti, vend ndertimet ndertimeve, punetore dhe racjonalizatore.

Mbeshtetja e dyte e PKJ ne zbatimin e politikes se saje asht katundarija punuese, ne rend te pare, katundarija e vorfen. Transformimet revolucjonare ne Vendin t'one mberrrein me qinda mija katundar dhe katundare nga terri i padijes, nga analfabetizmi e mbrapambetja dhe i shendrruen ne qytetare koshjente dhe ndertuesa te jetes se re. Problemat, te cilat sot paraqiten ne katundin t'one, nuk mundin mos me kontribue n'aktivizimin e gjithanshem te katundaris punuese në luften per pushtetin e vertete populIuer, per plotesimin e organeve te pushtetit te vendit, me permbajtje te vertete populIore, ne lufte kundra elementave eksploatuesa ne katund dhe per bashkimin e elementave punuesa ne levizjen kooperativiste bujqesuer. Ky asht burimi i dyte, i cili duhet te kontribuoje ne permiresimin e matejshem te perbanjes socjaliste te Partis s'one.

Te dyja keto burimet ma te randesishme te kuadrave te reja per Partin t'one, do te jene aq ma gjanesisht te hapuna, sa ma teper qe t'i realizojme me besnikl konkluzat e Kongresit te Peste, te cilat i perkasin zhdukjes se te gjitha pengesave-ilic e theksoi kete ne referatin e vet shoku Rankoviq-te cilat e pengojne inisjativen e turmave, te cilat i dobsojne pjesemarrjen e turmave ne jeten politike, ne kontroll e kritike, sa ma teper qe te sigurojne qe Partija t'a ndigjoi zanin e turmave, te mesoje prej turmave dhe t'a pranoje kritiken e tyne te drejte, guximshisht te turmave nga Fronti populIuer.

Tue i zgjanue ne kete menyre edhe ma teper ne t'ardheshmen lidhjet e veta me turmat populIore, Partis s'one do t'i duhet njikohesisht me i forcue vazhdimisht radhet e veta tue mbjelle ne koshjencen e antareve te vet te vertetat e madhe te marksizem-leninizmit, mjetit ma t'afte kundra influencimeve ideologjike te klaseve dhe grupeve te tyne te vjetrueme, por qe jetojne ende, kundra influencimeve te cilat e favorizojne mjanimin nga rruga e ndertimit te socjalizmit.

Tue ecune ma tutje ne rrugen qe ia ka çele vehtes mbrenda dhete vjeteve te fundit te zhvillimit te saje, Partija Komuniste e Jugosllavis, si fuqija udheheqese politike e ndertimit socjalist ne Vendin t'one, do t'ia perballoje te gjitha veshtersinave, te cilat doemos i sjelle me vedi realizimi i nje detyre aq te madhe historike.

## Art e Kulture

### Tue u-ba pjestare ne Theatrin t'one populIuer - te rijt e te rejat t'ona ndihmojne ne zhvillimin e popujve t'one dhe i sigurojne vehtes jete te kulturueme e te bukur

Po mbushen disa jave qe kane fillue pregatitjet per nisjen e veprimtaris te Theatrit populIuer krahinuer me qender ne Prishtine. Shi per kete arsye Ministrija e Arsimit e RP. te Serbis i ka zgjedhe e dergue ne Kosmet disa prej artistave ma te mire te Serbis dhe te Vojvodines, tue e emnue edhe drejtorin e Theatrit populIuer shokun Mile Jasniq, i shquem per kah aftsija e organizimit artistik dhe per kah talenti artistik.

Qe ne ditet e para drejtori bashke me shoket e tij ashte perpjeke qe ne terenin e Krahines te gjejne kuadra t'afta me prirje artistike. Ata deri tash kane mujet me gjete elementa vetem per plotsimin e grupit serb, ndersa per ate shqiptar ende jo. Kudo, ai dhe shoket e tij kane hase ne veshtirsina ne kerkesen e mashkujve e sidomos femnave shqiptare. Disa prinde qesin pengesa, gja qe i sjelle dam kolektivitetit si dhe vet femijve te tyne, te cilve puna ne theater do t'u siguroje nji jete te kulturueme e te bukur. Arti ke na nuk asht çmue asnjihere nder regjimet antipopullore. Popujve t'one nuk u asht dhane kurrfar ndihme ne zhvillimin e tyne, se ma artistik jo se jo.

Asht detyre e ne te gjithve qe te perpiqemi me te tana fuqit t'ona me gjete kuadra me prirje artistike dhe asish qe japin perspektiva nga vet jeta e popujve t'one. Te gjithe keta emnohen nepunesa shtetnore, tue i gezue te drejtat si te gjithe artistat e Vendit t'one. Keta do te ndihmohen sistematikisht nga shoket me eksperjence, qe dite per dite t'aftesohen, te zhvillohen tue u-ba ma te vleshem si per vehten e tyne ashtu edhe per popujt t'one.

Per te pase rezultate sa ma te mira e ma t'aferta, duhet qe forumet e Partis s'one Komuniste, Fronti populIuer, Bashkimi kulturo-arsimuer i çdo vendi a rrethi, rinija populIore, sindikatat dhe FAG-u, te perpiqen ma te gjitha fuqit e tyne qe nepermjet t'agjitacjonit te drejte te gjinden te gjitha elementat e vleshem,-mashkuj e femna shqiptare-per Theatrin populIuer krahinuer. Kjo asht nji detyre me randesi, prandaj perpjekjet duhet te vazhdojne deri atehere kur problemi te zgjidhet plotesisht.

Tash per tash puna e rregullt per grupin serb do te filloje me nji shtatuer, ndersa per grupin shqiptar ne fillim te tetorit. Atehere kur ne Prishtine shtepija e kultures te bahet e gatshme, shpresohet se grupi theatral serb do te paraqitet per te paren here ne skene; ne qofte se grupi shqiptar plotsohet ne kohe me kuadra e nevojshme, sigurisht paraqitja e tij nuk do te jete e larget. Prej kendej, te dy grupet kane me dhane çfaqje here mbas here nder viset e ndryshme te Krahines.

K. D.

—o—

### Ne Zveçan korren suksese ne kurset analafabetike

Ne fabriken Zveçan punojne 5 kurse analfabetike, nder te cilet rezultate ma te mira ka tregue ai i grupit te magazines kryesore qe perbahet prej 10 puntoresh analfabet. Udheheqsi i ketij kursi asht puntori Bajram Belirami, i cili nuk kursehet aspak per t'i ndihmue shoket e vet. Ai, ka dijte me udheheqe punen ne kurs, keshtu qe nji pjese e mire din t'i shkruej e t'i lexoje te gjitha germat, pjesa tjeter t'i lidhe ato fjale si me te shkruem ashtu edhe me te lexuem.

Ky asht nji shembull i mire nga i cili, duhet t'influencohen jo vetem grupet tjera te puntorve te Zveçanit por edhe te tjerat kudo ne Krahinen t'one, ne menyre qe mos te ngelç asnji puntuer pa e nxane shkrimin e kendimin.

## Shpallje

Theatri populIuer krahinuer i themeluem tash rishtazi blene:

Pjese te veshjeve kombetare serbe e shqiptare.
Arme te vjetra zjarri dhe te bardha.
Mobilje te ndryshme.
Stoli te vjetra (si vathe, bullzale, unaze e gjyslika, pipa çehlibari etj.)
Floke njeriu te çfardo ngjyre.
Bishtaleca (bystek)
Qylyma te ndryshem (sagjade etj.)

T'interesuemit mund t'ia pa'aqesin ofertat e tyne Drejtoris se Theatrit populIuer - ne ndertesen e Drejtorait t'Arsimit te Keshillit Krahinuer ne zyren Nr. 3, personalisht ose me shkrim.

Nga Drejtoria e Theatrit populIuer
Prishtine

# U-formue Bashkimi Krahinuer i kooperativave bujqesore per Kosmet

Me qellim riorganizimi te kooperativave bujqesore te vendeve, u-formue Bashkimi Krahinuer i ketyne kooperativave. N'Asamblen themeluese qe u-mbajte ne Prishtine, Rodolca Canoviq instruktor'i Inspektoratit per kaliet te Krahines, mbasi paraqiti suksesat dhe te metat ne punen e deritashme, foloi ne lidhje me riorganizimin ne fjale dhe, nder te tjera, tha:

"Nji kooperative fshatare mundet me pase keto keshilla: keshillin per bujqesi, per fruta, per vneshte, per perparimin e blegtoris dhe per sigurimin e kafsheve, per tregtin kooperative, per kursime dhe kredite, per ekonomin lokale, per punen kulturo-arsimore, per punimin e perbashket te tokes dhe keshillin per elektrifikim.

Me rastin e riorganizimit te kooperativave do te themelohen vetem ato keshilla, per te cilat parashihet nevoja simbas strukturës ekonomike te kooperatives. Keto keshilla do t'i mesojne kooperativistat per punimin kolektiv te tokes. Ndihma reciproke ne bujqesi nuk asht gja e re per bujkun t'one.

Akcjonet e ndryshme te punes, te cilat i kane zbatue bujqit t'one neper mjet te Frontit popullor, i kane afrue katundaret t'one dhe i kane mesue per punen kolektive.

Ne keshillin per bujqesi, per shem-bull, kooperativistat do t'iu bashkohe qe te munjshin me i cfrytzue ma mire si fuqin punuese, ashtu edhe maqinat ne pronat e tyne, me anen e punimit kolektiv. Antaret e ketij keshilli do t'jshin vetem ata kooperativista, te cilet e shprehin deshiren se duen me e punue token ne menyre te perbashket, per dallim nga keshillat e tjera, antaret e te cilave jane te gjithe kooperativistat e nji kooperative. Keshilli do te mbante evidencen e vet-llogarin, nga e cila do te shihesh me perpikni se gka ka punue secili ne punen e perbashket.

Gjithashtu, per shkak te zhvillimit ma te drejte te punes dhe te shperblimit per punen e kryeme, keshilli do te kishte caktue normen e punes qe don me thane se kooperativisti, i cili punon ma teper dhe ma mire do te kete meditje ma te madhe.

Çdo kooperativist e mban gjane e vet, veglat, token, etj. ne duert e veta dhe disponon me to simbas deshires se vet. Ne fund te sezonës se punes bahet llogaritja dhe çdo kooperativisti i paguhet puna, te cilen e ka dhane si ma teper se sa asht e nevojshme per punimin e tokes se tij, gja qe do te shihet nga evidenca e kooperatives. Gjithashtu, simbas vendimit te kooperativistave paguhet edhe perdorimi i veglave, te cilat do te mlerrn prej tyne.

# Plotsimi dhe tjekalimi i planit te perditshem ne minjeren Trepça

Per dite e ma teper vjen tue u shtue kushjenca e punjtorve ne punen e perditeshme ne minjeren e Trepçes. Punteret e rafinerls e kane tejkalue normen e zbrazjes se metalit per 45%.

Shoket Arif Arifi dhe Fejzullah Sejdiu, te paludhshem ne pune dhe me nji vullnet te çelnikat e kane tejkalue normen e zbrazjes se qymyrit per 40%. Mbas ketyne e kane kalue normen 50%, puntoret Adem Hazyri dhe Shaban Rama.

Puntoret Azim Shaqiri, Sulejman Sefori, Nezir Nura, Ahmet Sadrija dhe Adem Xangjel e kane kalue normen e ngarkimit te plumbit ne vagona e mbylline me 40%.

Me 14 te ketij muaji puntori Myftar Bajrami e ka tejkalue normen me 47%. Mbrenda po kesaj dite ne mbushjen e vagonave me plumb, e kane tejkalue normen me 80% puntoret Radijeviq Mihajl, Milivojeviq Millutin, Ibrahim Dibrani, Miletiq Miladen, Karopka Rane dhe Borzuz Dushan.

### Ne Ferizaj sindikalistat nderlojne rrugen nga Brodi ne drejtim te Lubotenit

Deget sindikale te rrethit te Ferizajt kane marre persiper ndertimin e rruges per qerre me gjatesi kater kilometra, prej Brodit ne drejtim te Lubotenit.

Kjo rruge do te sherbeje ma se shumti per transportimin e drunit per dimen per te gjithe puntoret e nrpunsat. Padyshim, ky asht nji aksjon me vend sepse sigurohet me kohe dhe qind per qind lenda djegese per familjet e sindikalistave.

Ne ket rruge deri tash kane marre pjese ne pune 530 puntore e nepunsa. Punohet per çdo te diele, e shpresohet se rruga do te kryhet se nderumi mbrenda nji kohe te shkurte.

# Nga situata nderkombtare

## Ne lidhje me noten e Qeveris se RFPJ drejtue Qeveris se RP te Rumanis

Me 25 te ketij muaji, Ministri i Punve te Jashtme te RFPJ, Stanoje Simiq i dorzoi ambasadorit te Republikes Popullore te Rumanis ne Beograd, z. Teodor Rudenko nji note me te cilen Qeverija e jone protestan per fushaten qe jane tue zhvillue ne kto muaj e fundit funksjonaret, shtypi, radjo rumune etj. kundra RFPJ, Qeveris se RFPJ dhe popujvet te Jugosllavis, fushate e cila asht ne kundershtim te plote me Paktin e miqesis, bashkpunimit dhe ndihmes reciproke, nenshkrue ne mes te dyja Vendevet. Ne note theksohet se fushata ne fjale nuk asht e justifikuese as nga pikpamja e marredhanjeve te zakonshme nderkombetare, se je ma nga pikpamja e marredhanjeve te mira normale te fqinjesi ndermjet te dy shtetevet. "Qendrimi i ketille ndaj nji Vendi, ku populli dhe perfaqesuesit e tij legjitime perpiqen me te tana fuqit e veta per ndertimin e nji rendi ma te nalte shoqnor, rendit socjalist, ndaj Vendit qe, nga ana e tij, nuk ka dhane kurrfare shkaki per trazimin e miqesis ne mes te popujve te Jugosllavis dhe popullit rumun, nuk mund te quhet qendrim'i drejte ne mes te dy shteteve te demokracis popullore te cilet ndertojne socjalizmin. Nji kesi qendrimi nuk mund te merret ndryshej veçse si perpjekje me iu kundervue nji rendi demokratik popullor. Kjo perpjekje s'ka kurrgja te perbashket me bashkpunimin vllazner dhe marredhanjen miqsore, e sjellerte me qellimet eventualisht ne komentim. Metodat e ketilla u ndihmojne imperjalistavet qe te shpifin kundra Vendeve te demokracis popullore, t'i ashpersojne mosmarreveshjet ne mes te ketyne, t'a shtojne fushaten e tyne kundra principeve te sovranitetit dhe barazis kombetare te shteteve te ndryshme".

Nji fushate e ketille asht krejt e pa kuptueshme aq ma teper kur te merret parasysh se pikpamjet ne mes te te gjitha vendeve te demokracis popullore dhe socjalizmit „perputhen ne te gjitha çeshtjet themelore". „Metodat e ketilla nuk duhet te kishin asnji vend ne marredhanjet ne mes te shteteve qe ndertojne socjalizmin".

Fushate ne fjale nuk te ket asnji dale „shtetje qe ka perdore deri tani propaganda borgjeze kundra vendeve qe jane shkeputë nga kontrolli i imperjalizmit nderkombetar" dhe „praktikisht don te thote — me e dobsue frontin unjitetine dhe pozitat e RFPJ karshi fuqive imperjaliste dhe „me ndihmue shtimin e presjonit imperjalist kundra RFPJ".

Ne note theksohet se ne keto muaj e fundit, ne RP te Rumanis zhvillohet nji fushate ma e fortneme kundra RFPJ — e cila ndertion socjalizmin e me te cilen Rumanija e ka te nenshkruem paktin e miqesis, bashkpunimit dhe ndihmes reciproke-se sa kundra lufte-nxitsave imperjalist.

Ne fund, ne note theksohet se fushata ne fjale prishe marredhanjet ne mes te popujve te te dyja vendeve dhe con nje veren ne mulli t'armiqve te Vendeve te demokracis popullore dhe socjalizmit.

Nji note te ketij dite i asht drejtue nga ana e Qeveris s'one edhe Qeveris se Hungaris.

## Sulmet dhe kundra-sulmet e sukseshme te njisive t'Armates Demokratike te Greqis

Simbas lajmeve te radjo stacjonit te Greqis se lire, njisit e Armates Demokratike te cilat operojne ne territorin e Epirit, me 23 gusht zbrapen sulmin e monarko-fashistave ne pozitat e Ellafotis e Gorilcs. Tue kalue mbasandej ne kundrasulm, thyen armikun, tue i shkaktue humbje te mdhaja: 15 ushtare te vdekun, dhe 35 te plagosun. Armiku u detyrue te terhiqet ne bazen e vet. Ne sektorin e Gramosit njisit e Armates Demokratike kane vazhdue me sulme ne befasi dhe i kane shkaktue armikut humbje serioze.

Njisinat e Armates Demokratike qe operojne ne Maqedonin Lindore dhe ne Traki, kane depertue ne mbrapavijen e armikut ne teritorin Orestijada-Evros. 60 ushtare monarko-fashista jane nxjerre nga beteja. Ne radhet e Armates Demokratike kane hype 170 luftetare te ri.

Njisit e Armates Demokratike vazhdojne akcjonet ofensive ne Maqedonin Qendrore. Ne ket sektor lufte jane sulmue nji seri vendesh ndej te cilat edhe Metaliko, Terpilo, Helko, Hori, Varvari etj. Ne keto operacjone ofensive monarko-fashistat kane lane 47 te vdekun e te plagosun. Po ne ket teren jane hedh n'ajr, 3 ura dhe asht shkatrrue pjesa ma e madhe e hekurudhes s'armikut.

**ATHINE:**

Radjo-stacjoni i Greqis se lire e transmetoi urdhnin e komandantit madhor t'Armates Demokratike te Greqis te gjeneralit Markos ne te cilin e lavdroi batalionin e brigades se gjashte mbedhere nen komanden e nenkolonelit Alexias dhe nji cete te se njajtes brigade nen komanden e majorit Zois. N'urdhen theksohet se njisite e permenduna jane dallue veçanerisht me sulmet e guximshme ne pozitat e armikut ne majen e Alevices, sepse ne kete pike e kane thye vijen e fortifikueme t'armikut dhe se ne kete menyre e kane lehtesue kalimin e njisive t'Armates Demokratike ne mbrapavijen e armikut.

## Ma se 15.000 ushtare te Kuomintangut jane zane rob ne Hupj-in verior

**Shensi Verior:**

Agjensija „Tanjug" lajmeron se agjensija „Kina e re" njofton se fuqit e Armates Nacjonal-Clirimtare te Kines, te cilat bajne operacjone gjate derdhjes se lumit Jangce i japin grushte gjithnji ma te mdhaja trupeve te Kuomintangut ne bregun verior te lumit.

Njisit e Armates Nacjonal-çlirimtare kinze, te cilat bajne operacjone ne Hupj-in verior, ne gjysmen e pare te ketij muaji kane zane rob ma teper se 15.000 ushtare te Kuomintangut, si edhe shefin ne zi per te keq te polisis sekrete te Kuomintangut — Kang — Cean. Ma tutje kah lindja, n'Anhuein prendimor njisit e Armates Nacjonal—çlirimtare ne fushen e guallit ne luftat para qytetit krahinuer — Cinyang, ne veri te Nankingut i kane zane rob 495 ushtare.

Te derdhja e lumit Jangce, n'afersi te qytetit krahinuer Taihsien, fuqit e Kuomintangut gjate luftave kane pase 800 te plagosun e te zanun rob, e, mandje kah veri-lindja, n'afersi e qytetit krahinuer — Jukan, 400 te plagosun edhe te zanun rob.

Armata Nacjonal-çlirimtare e Kines u ka dhane liri 4 gjeneral majorave dhe 95 oficerave me gradime prej togerit deri ne kolonel te Kuomintangut, te cilet kane qene te zubauem ne qershor dhe ne korrik ne luftat n'afersi te qendres se Kuomintangut — Manjange, ne Honanin prendimuer.

### „Per shkak te masave jo ligjore te komandes anglo-amerikane ne Teritoriu e lire te Triestes gjendja po bahet gjithnji ma e zaftesuame dhe mâ e rreziksheme" — shkrun „Novoje vremja"

**Moske:**

Agjensija Tass lajmeron:

Revista „Novoje vremja" shkruen se problemi i statutit te Teritorit te lire te Triestes akoma nuk asht i zgjidhun.

Per shkak te masave separatiste dhe joligjore te komandes anglo-amerikane — shkruen revista gjendja ne teritorin e lire te Triestes po bahet gjithnji ma e shqetsueme dhe ma e rrezikshme. Problemi i Triestes nuk po hiqet nga rendi i dites ne Keshillin e sigurimit, e edhe atje e mbrojne lapine delegatet anglo-amerikane. Ushtarët e kjarte se pushteti anglo-amerikan tue ua dhane ne zotnim po kontrollon kete lama te rendesishme te Mesdheut, per te cilin jane t'interesueme nji varg shtetesh. Anglo-amerikanet e konsiderojne kete lama si kopsht te tyne dhe baze te pranishme ushtarako-detare ne Ballkan. Perfaqesuesi sovjetik ne Keshillin e sigurimit ka qene i detyruem me konstatue se Shtetet e Bashkuame t'Amerikes dhe Bretanija e Madhe e shkelin traktatin e paqes me Italin dhe vendimin e Keshillave te ministrave te punve te jashtme „dhe jane nise ne rrugen e mospjektimit te detyrimeve te marruna persiper qysh perpara dhe pungimit te lotyeve sevdianeve.

—o—

**ROME:**

Sindikatat sovjetike i fallen kooperativave bujqesore t'Italis 15 traktora. Tre traktora kane mberri ne limanin e Napolit e te tjeret do te mberrijne gjate muajit Cardheshem.

Konfederata e bujqeve i falemneroi sindikatat sovjetike n'emen te te gjithe puntorve bujqe t'Italis per kete mbresi konkrete te solidaritetit.

# Fiskultura dhe Sporti

## Loje apo zihje

Loja e voli—bollit dhe basket-bollit ka fillue me ngjalle interesin bukur te madh ne publikun t'one, sidomos ke rinija.

Por ndeshja qe u zhvillue kete dit, te ne mes te skuadres se shoqnis „Proleter" dhe „Polet" ne Prishtine nuk la fort perdhtypjen e duhun, tue se jetojne ende ne kohen e vjeter.

[illegible] ka munguar kryekepat. Gjadi nje lojtar qe ka arbitar lojtar [illegible] me [illegible] ndolonsh hunde e buze, [illegible] „dinnollje" asht zhvillue ndeshja e [illegible] te sporte. [illegible] keta dy skuadra perbahen prej njerzish qe duhet dhe mund te sherbejne shmni si [illegible] te [illegible] teknike e ketyne degve te sportit [illegible] dhe te veprimin e dregje te [illegible] te kvalitetit popullor te [illegible].

Per te mos ndodhun ghagje mosmarveshje te lojtarve ndaj arbitrit asht nevoje qe te zotohen [illegible] prej tyne rregullores perkatese.

Asht detyre e sportistave ma te vjeter, qe te japin shembull se si duhet me e ba fiskulturen jo vetem nji mjet forcimi trupor, por edhe argetim e edukate.

Ne mes te „Proleterit" dhe te „Polotit" nevojitet nji bashkpunim dhe harmoni e plote vllaznore. Nuk ka hije te perseriten ma disa ghagje negative si deri tash. Ne mes te tyne mund te zhvillohet gare e shendoshe konkurrimi, por kesaj te mos i jepet ma karakteri si deri.

—o—

## Ndeshja e qitjes ne shej

Ne Kragujevc ka fillue ndeshja e qitjes ne shej per kampionatin e Republikes Federative Popullore te Jugosllavis. Ne kete ndeshje merr pjese edhe nji ekipe nga Krahina e jone e cili perbahet nga shejtaret e mire, te cilet nuk kane ba stervitje, por kane nji fare praktike dhe eksperjencen e duhun. Pjestare t'ekipes t'one jane: Vilahoviqi, Gjorgjeviqi Voja Shaban, Zoin Krasniqi dhe shoqja Zlata [illegible].

—o—

## Ndeshjet qe do te bahen sot

Sot ne Prizren bahet ndeshja revansh, per te marre pjese ne „[illegible]", ndermjet Sh. S. „Metohija" dhe Sh. S. „Borac" ndeshje e mapareme ne mes te ketyne dy ekipave ka perfundue 2:1 ne favor te skuadres „Borac".

Ne Prishtine ka mberrijte skuadra e Sh. S. „Dinamo" nga Shkupi, kampjoni e Republikes Popullore te Maqedonis dhe pjestare e ligës se dyt federative. Kjo do te bane nji ndeshje miqsore me skuadren e Sh. S. te katushme „Proleter".

Botimi i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor—Sipermarrja per shtyp dhe botime "Milladin Popoviq", Prishtine.
Pajimet ne lletoren i pranon: Administrata dhe ekspedicioni. Numri i çekut 906010.